



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Siguria nga krimet kibernetike

Të dhëna bazike të lëndës: Siguria nga krimet kibernetike	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike-Fakulteti Juridik-Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Siguria nga krimet kibernetike
Niveli:	Master E-Qeverisja
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve/Semestri:	Viti i II-të, Semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha /lokacioni:	Semestri dimëror, Gjilan
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. ass. dr. Fejzullah Hasani
Asistent	Asistent: Shkelzen Nuza
Detajet kontaktuese:	ffhasani60@hotmail.com, tel: 045-321-690
Përshkrimi i lëndës:	<i>Siguria nga krimet kibernetike, është lëndë obligative për studime master, në programin e përbashkët të Universiteteve: "Kadri Zeka" në Gjilan, "Ukshin Hoti" në Prizren dhe "Haxhi Zeka" në Pejë, për studentët e viti të II-të. Lënda përkatëse ligjërohet në semestrin e tretë (3) dimërorë dhe përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore, që u mundësojnë studentëve arritjen e njohurive për krimet kibernetike, si formë e re e shfaqjes kriminale.</i>
Qëllimet e lëndës:	Ky program mësimor, mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga: <i>Siguria nga krimet kibernetike</i> , e cila si pjesë e shkencës juridiko-penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit. Programi mësimor nga lënda <i>Siguria nga krimet kibernetike</i> , do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Qëllimi i këtij programi mësimor është që studentët të marrin njohurit elementare për këtë formë të re të kriminalitetit, format e mundshme të paraqitjes, motivet-qëllimet e këtyre veprimeve

	<p>kriminale, format e mundshme të abuzimit me kompjuter dhe internet, pasojat që rezultojnë nga këto veprime abuzive, si janë të trajtuara këto veprime në aspektin legjislativ në Republikën e Kosovës dhe në shtetet e tjera si dhe masat që ndërmerren nga segmentet e caktuara të shtetit siç janë: Ministria e Drejtësisë, ajo e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, AKI-ja etj., me qëllim të mbrojtjes nga këto veprime kriminale.</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	/	/	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0,5-1	15	15
Ushtrime në teren	/		/
Kollokfiume ,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	/	/	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1.5	15	22.5
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim(teste,provim final	2	4	8
Projektet, prezantimet etj			
Totali:			105,5

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim - duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike.</p> <p>Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë teme apo punimi seminari. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve</p>
-------------------------------------	---

	<p>zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund bëhet vlerësimi i punimit.</p> <p>Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose me shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore</p> <p>Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane. Prezantimi i temës në Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar.</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 50 pikë Provimi përfundimtar: 0-50 pikë Punim seminarik: 0-10pikë Prezantime: 0-5 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 0-5 pikë</p> <p>Totali: 100 pikë.</p> <p>Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese</p>
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<p>Veton Vula–Mensut Ademi, <i>Krimi kompjuterik, Botimi i dytë</i>, 2018</p>
<p>Literatura shtesë:</p>	<p>Prof. dr. Ismet Salihu, <i>E drejta penale-pjesa e përgjithshme; UP</i>, 2016;</p> <p><i>Komentari i Kodit Penal të Kosovës-Pjesa e përgjithshme, Grup autorësh, botimi 2013;</i></p> <p><i>Kodi Penal i Kosovës (2018);</i></p> <p><i>Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike nr. 03/L-166, 10 qershor 2010 dhe</i></p> <p><i>Sstrategjia shtetërore për sigurinë kibernetike dhe plani i veprimtimit 2016–2019.</i></p>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java e parë:	Trajtimi teorik dhe juridik mbi mënyrën e shfrytëzimit të kompjuterit si mjet për kryerjen e krimit; Fillet e paraqitjes dhe definimit të krimit kompjuterik
Java e dytë:	Interneti; Shfrytëzimi i internetit nga grupet e krimit të organizuar për joshjen e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore; Fusha e përdorimit të internetit nga grupet terroriste; Interneti si mjet propagande
Java e tretë:	Trajtimi juridiko-penal i krimit kompjuterik; Rregullimi juridiko-penal i kriminalitetit kompjuterik në disa shtete të Evropës
Java e katërt:	Trajtimi kriminalistik i krimit kompjuterik; Hetimi dhe zbulimi i krimit kompjuterik; Indiciet; Pasojat e veprave penale-krimeve kibernetike; Forenzika kompjuterike; Aplikimi i forenzikës kompjuterike; Provat digjitale; Sigurimi i provave digjitale
Java e pestë:	Krimi kompjuterik në raport me krimin e organizuar; Mashtrimi me rastin e pagesave përmes kartelës bankare; Mashtrimet kompjuterike; Falsifikimi kompjuterik; Sabotazhi kompjuterik; Dhënia e sekretit; Spiunazhi kompjuterik ; Pornografia kompjuterike; Propaganda kompjuterike
Java e gjashtë:	Kollokfiumi i parë
Java e shtatë:	Krimi i organizuar dhe krimi kompjuterik në regjione të ndryshme të botës; Disa forma dhe karakteristika themelore të krimit kompjuterik; Hakingu; Hakingu profesional; Krijimi dhe distribuimi i viruseve; Prirateria e softuerve
Java e tetë:	Veçoritë sociale dhe personale të personave që merren me krimin kompjuterik; Tipet e kryesve të krimit kompjuterik; Format e kryerjes së krimit kompjuterik;

	Numri i errët i krimeve kompjuterike
Java e nëntë:	Karakteristikat etiologjike të krimit kompjuterik ; Faktorët objektiv; Faktorët subjektiv
Java e dhjetë:	Parandalimi dhe luftimi i krimit kompjuterik; - masat për parandalimin e krimit kompjuterik , - masat administrative, - analiza e rrezikut, - vendosja e programit për siguri, - mbrojtja juridike si përgjigje ndaj keqpërdorimeve të sistemeve kompjuterike, - etika kompjuterike dhe arsimimi, - bashkëpunimi ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e krimit kompjuterik, - rehabilitimi i sistemeve të informacionit
Java e njëmbëdhjetë:	Aspekti ndërkombëtar i krimit kompjuterik; Aktiviteti i organizatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e privatësisë
Java e dymbëdhjetë:	Perspektiva e krimit kompjuterik; Lufta informatike; Klasifikimi i luftës informatike
Java e trembëdhjetë:	Kiber terrorizmi
Java e katërbëdhjetë:	Disa raste praktike të krimit kompjuterik
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollokfiumi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	